

ZGJEDHJET EUROPIANE: PERQAFIMI I MESDHEUT DO TE THOTE SHPETIM I EUROPE

APEL

Mesdheu është djepi i qytetërimit të krejt Europës dhe, kur mbrojmë konceptin e dy pjesëve të ndara e të kundërta, thjesht po injorojmë, për të keqen dhe rrezikun tonë, historinë mijëvjeçare të kontinentit. Mesdheu ka sjellë në jetë gjuhë, besime, sisteme filozofike dhe disiplina shkencore që kanë kontribuar në rritjen e qytetërimeve të ndryshme që janë zhvilluar në rajon përgjatë historisë së saj. Ka përfaqësuar hapësirën e privilegjuar në të cilën kulturat e popujve të Lindjes së Afërt, Afrikës së Veriut dhe Europës së Jugut mund të viheshin në kontakt, të përziheshin e të amalgamoheshin. Ka qenë djepi i shoqërive të para urbane të Lindjes, të qytetërimit greko-romak, të atij judeo-kristian dhe mysliman, i periudhave të ndritura si Rilindja. Konteksti ku kanë lindur qytete kozmopolite si Aleksandria, Tanzheri, Venediku, Kostandinopoja, Selaniku dhe Dubrovniku. Prej mijëvjeçarësh Mesdheu është një kryqëzim ku njerëzit, kafshët, mallrat anijet, idetë, fetë, stilet e jetesës e madje edhe bimët, përzihen dhe pasurohen.

TË RINOVOJMË NËNSHTETËSINË PËR TË SHPËTUAR EUROPËN

Sot janë të përfshira shumë forca politike për “të shpëtuar” projektin europian nga nacionalizmi, nga narrativat identitare, nga regjimet joliberalë që mohojnë përparimet e mëdha të kryera në kontinentin europian në fushën e njohjes së të drejtave, lirive dhe përgjegjësive demokratike.

Megjithatë, “të shpëtosh” Europën pa përqaftuar Mesdheun është një kauzë e humbur. Europa nuk mund të ripërtërihet duke i mbyllur kufijtë e vet gjeografikë dhe kulturorë: ky do të ishte fundi i projektit të integritimit europian.

Të drejtat nuk mund të jenë privilegj i disa kombeve në dëm të të tjerëve, në veçanti të atyre të afërt. Diferencimi i regjimeve të nënshtetësisë në Mesdhe – me staturë dhe forma përkatësie të shumëllojshme, si dhe me të drejta, detyra dhe përgjegjësi nganjëherë të lëkundura – mund të tejkalohet vetëm me një nënshtetësi transnacionale, të frymëzuar nga shpirti mesdhetar i bazuar tek diversiteti, shkëmbimi dhe mikpritja, ku as eurocentrizmi dhe as autoritarizmi të mos krijojnë diskriminime individuale dhe sociale në bazë të kombësisë, fesë, gjinisë apo klasës shoqërore.

EUROPA MUND TË RIPËRTËRIHET VETËM NËSE I OFRON MESDHEUT NJË FAT TË PËRBASHKËT

Ky është apeli ynë drejtuar qytetarëve europianë në vigjilje të zgjedhjeve europiane.

Europa mund të vazhdojë të jetë një far i humanizmit nëse do të jetë e aftë të mishërojë, në mënyrë empatike, vlerat pozitive të trashëguara në udhëkryqin e Mesdheut. Dhe për të parandaluar shpërbërjen duhet të çojë deri në fund procesin e integritimit ndaj këtij rajoni.

Prandaj u kërkojmë forcave politike që marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare europiane të 2019 të mbështesin një nismë të re për integrimin midis kontinentit europian dhe hapësirës mesdhetare.

Hapësirë në të cilën jeton një komunitet prej rreth gjysmë miliardi personash me një pasuri kulturore unike; shtëpi e mbi tridhjetë gjuhëve; me peizazhe magjepsëse dhe biodiversitet të jashtëzakonshëm, e dyta menjëherë pas pyjeve ekuatoriale, ; me një kulturë rurale dhe ushqimore të mirënjohur globalisht; me burime të jashtëzakonshme energjie dhe, së fundi, me një potencial fantastik njerëzor në shkenca, kulturë, zhvillim ekonomik, shpirtëror, në punë dhe krijimtari.

NJË INICIATIVË DIALOGU NË SHKALLË RAJONALE DHE NJË PROCES KUSHTETUES ME RËNDËSI TË GJERË

Është i nevojshëm një vizion i qartë dhe unitar për Europën dhe Mesdheun, i cili të përkthehet në një nismë dialogu rajonal dhe, me përfshirjen e qytetarëve dhe komuniteteve të të dyja brigjeve, në një proces kushtetues të zgjeruar.

Nëse Europa sheh vetëm nga vetja, nuk mund të gjejë zgjidhje për sfidat që ka përpara: as në fushën e riformulimit të modelit të zhvillimit, të politikave të emigracionit, ndalimit të degradimit mjedisor, të gjenerimit të mundësive të punës dhe mirëqenies, të konsolidimit të hapësirave demokratike; as në përballimin e terrorizmit dhe nacionalizmave të bazuar në urrejtje.

75 vjet më parë, kur akoma vlonte Lufta e Dytë Botërore, një grup intelektualësh dhe militantësh antifashistë, të internuar në ishullin e Ventotenes, shkruan Manifestin për “Europën e Lirë e të Bashkuar”. Ai Manifest hodhi vizionin e integritimit europian si motor paqeje dhe prosperiteti në një moment kur askush nuk mund të vinte bast për këtë.

Sot mund të themi se jetojmë një formë të re lufte globale, mes kulturash dhe identitetesh fetare të vëna kundër njëra-tjetrës, në të cilën luftërat për lirinë dhe drejtësinë frustrohen në emër të stabilitetit, rritjes dhe interesit kombëtar; ku shumë familje janë detyruar të largohen nga dëshpërimi dhe ku zgjerohet konflikti mes qenieve njerëzore dhe natyrës.

Fronti më i nxehtë i kësaj lufte përshkon Mesdheun, për të cilin bëhet ky apel, të vetëdijshëm për momentin që po jetojmë, për një “Mesdhe të lirë dhe të bashkuar në një fat të përbashkët me Europën”.

ZGJEDHJET EUROPIANE 2019: RASRI I DUHUR PER TE PERQAFUAR MESDHEUN

Kur më në fund të dy brigjet të takohen dhe të përqafohen, jemi të bindur se institucionet e tyre, burimet, inteligjenca dhe potencialet njerëzore do të ofrojnë zgjidhje për të shpëtuar Europën nga tundimi i shpërbërjes, dhe vendet e afërta mesdhetare nga autoritarizmi dhe kaosi.

Ky është programi që do të dëshironim në agjendat e forcave politike të këtyre zgjedhjeve europiane të 2019. Është trashëgimia që Europa dhe Mesdheu mund të pretendojnë së bashku, në mënyrë që, edhe një herë të kthehen në një far të humanizmit, mikpritjes dhe përparimit.



MAYDAN is an association of citizens, women and men, including activists, intellectuals, artists, entrepreneurs, researchers and others, engaged in the construction of a Mediterranean citizenship and a common destiny among the peoples of the region.

www.maydan-association.org